



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 19, datë 27.01.2021**

**PËR**

**LICENCIMIN E SUBJEKTIT “RENTAL TRAVEL” SH.P.K., PËR USHTRIMIN E  
VEPRIMTARISË SË AGJENTIT NË SIGURIME, NË KLASAT E JO-JETËS, NË EMËR  
DHE PËR LLOGARI TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT “SIGAL UNIQA GROUP  
AUSTRIA” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe Rregullores nr. 79, datë 31.08.2015 “Për miratimin/licencimin e personave për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime si dhe rastet e mospranimit të regjistrimit të tij dhe refuzimit të licencës”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I :**

- 1. Licencimin e subjektit “Rental Travel” sh.p.k., për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime, në klasat e Jo-Jetës, në emër dhe për llogari të shoqërisë së sigurimit “Sigal Uniqa Group Austria” sh.a.**
- 2. Miratimin e z. Ervis Kurti për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime, në klasat e Jo-Jetës, në emër dhe për llogari të subjektit “Rental Travel” sh.p.k.**
- 3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**ANËTAR**

**Deniz DERALLA**

**NËNDREJTOR EKZEKUTIV**

**Mimoza KAÇI**